

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 656 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 95, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Sondazheve Arkeologjike në zonën e e Gradishtës së Peshtanit KP 134+500 -133+500, pranë bregut të Hamamit dhe Goricës së Dukës, Berat, Fushata III e gazsjellësit TAP; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në këtë zonë, paraqitur nga "ABKONS" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Sondazheve Arkeologjike në zonën e e Gradishtës së Peshtanit KP 134+500 -133+500, pranë bregut të Hamamit dhe Goricës së Dukës, Berat, Fushata III e gazsjellësit TAP; Konceptin dhe metodologjinë e kryerjes së gërmimit arkeologjik të shpëtimit në këtë zonë, paraqitur nga "ABKONS" sh.p.k.
2. Gërmimi arkeologjik i shpëtimit do të kryhet nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., në vijim të akt-marrëveshjes së mëparëshme të lidhur për kryerjen e sondazheve arkeologjike në këtë zonë, ndërmjet "TAP AG", kësaj shoqërie dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i gërmimit arkeologjik të shpëtimit të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

